



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 37/2015

Prishtinë, më 10.11.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Veli Hoti, Selvije Qekaj dhe Bashkim Navakazi- MTI; Luan Morina, Fazile Bekteshi dhe Deniza Shabanaj-MZHE; Mkhael Golo, Gary Gegenheimer, Haxhi Gashi, Njomëza Zejnullahu-USAID/Empower; Dardan Abazi- INDEP; Sanije Berisha- OSBE; Fjolla Uka – KDI dhe Adriana Sejfia-GAP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.11.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-058 për Dizajnin Industrial;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike;
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.10.2015

Procesverbali i mbledhjes së datës 27.10.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, foli për rëndësinë Projektligjit për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, ku tha se ky projektligj ka një rëndësi të jashtëzakonshme pasi që garanton një fond kreditor për investitorët, qoftë të brendshme dhe të jashtëm për të investuar në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ai, në cilësinë e kryesuesit të Grupit të punës, theksoi se Projektligj në fjalë ka kaluar në leximin parë në sancën plenare, pastaj Grupi i punës e ka shqyrtuar dhe i ka analizuar me kujdes propozimet e paraqitur në dëgjimin publik, që është organizuar nga ana e Komisionit dhe ka bashkëpunuar ngushtë edhe me përfaqësuesit e projektit të USAID-it, ku i ka marrë për bazë dhe propozimet e tyre. Z. Mustafa, tha se Grupi i punës ka nxjerrë disa amendamente të cilat i prezantoi një nga një para komisionit.

Amendamenti 1

Ndërrohen vendet e nenit 1 me nenin 2, ku neni 1 bëhet neni 2, ndërsa neni 2 bëhet neni 1.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 2, fjalia e fundit “Bordit Menaxhues”, zëvendësohet me “Bordit të Drejtorëve”. Në tërë tekstin e ligjit kur përdoret shprehja “Bordit Menaxhues”, zëvendësohet me shprehjen “Bordit të Drejtorëve”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 3, përkufizimi 1.1, në vend të përkufizimit “Aktet nënligjore”, zëvendësohet me tekstin si vijon:

1.1 Statuti i FKGK- së, tërësia e rregullave të FKGK- së të aprovuara Bordi i Drejtorëve, të cilat rregullojnë funksionimin e tij, organizmin e brendshëm dhe organizimin e fondit në harmoni me këtë ligj.

Në tërë tekstin e ligjit kur përdoret shprehja “Aktet nënligjore” zëvendësohet me shprehjen “Statuti dhe Politikat e Procedurave të Brendshme”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 4

Neni 3, përkufizimi në 1.5, në tërë tekstin e ligjit kur përdoret shprehja “Komitetet e Bordit Menaxhues”, zëvendësohet me shprehjen “Komitetet e Bordit të Drejtorëve”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 5

Neni 3, përkufizimi në 1.13, në fund të tekstit shtohet teksti si vijon:

Shuma e tarifës së garancisë do të mbulojë shpenzimet operative dhe humbjet kreditore të FK GK- së, për të mundësuar qëndrueshmërinë e FK GK- së.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 6

Neni 3, përkufizimi 1.25, zëvendësohet me tekstin si vijon:

1.25. Palet e ndrlidhura - çdo person që ka së paku njërën nga marrëdhëniet e më poshtme me NMVM:

- (1).çdo menaxher i lartë ose drejtor i NMVM-së dhe çdo aksionar kryesor i NMVM- së;
- (2).çdo person që është i afërt me Menaxherin e lartë ose Drejtorin apo me aksionarin kryesor të NMVM- së, që lidhen me martesë ose afërsi të gjakut deri në shkallë të dytë;
- (3).çdo person juridik në të cilin menaxher i lartë ose drejtori apo aksionari kryesor i NMVM-së është po ashtu aksionar kryesor;
- (4).çdo person që ka interes të konsiderueshëm në personin juridik, ku NMVM ka interes të konsiderueshëm;
- (5).çdo filial i NMVM- së
- (6).çdo person tjetër i përfshirë në marrëdhënie me NMVM, ngjashëm me personat e identifikuar në nënparagrafët 1-5 të këtij paragrafi, që FK GK e përcakton me politikat dhe procedurat e tij që është palë e ndërlidhur me NMVM.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 7

Neni 3, shtohet një përkufizim 1.27 me tekstin si vijon:

1.27. Drejtori Menaxhues - një udhëheqës ekzekutiv i FK GK- së, i emëruar nga Bordi i Drejtorëve me përgjegjësitë e specifikuar në nenin 20 të këtij Ligji.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 8

Neni 3, shtohet një përkufizim 1.28 me tekstin si vijon:

1.28. Humbjet Kreditore-tërësia e shumës së pagueshme të cilën FKGK ia paguan Institucionit të Regjistruar Financiar kundrejt kërkesës së paraqitur për pagesë pas dokumentimit të Rastit të Garantuar.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 9

Neni 5, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. FKGK-ja mund të lëshojë Garanci Kreditore apo produkte dhe shërbime të tjera të miratuara në përputhje me këtë Ligj dhe me aprovim të Bordit të Drejtorëve, siç përcaktohet në nenin 17 të këtij Ligji. Çdo produkt apo shërbim i ri i nënshtrohet dispozitave të Nenit 9 të këtij Ligji, duke përfshirë edhe aprovimin nga BQK-ja.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 10

Neni 8, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Institucioni i regjistruar financiar i paguan FKGK-së Tarifën e Garancisë në kohën kur Kredia i nënshtrohet Garancisë Kreditore në FKGK, si dhe çdo vit pas kësaj për shumën e mbetur të papaguar të kryegjësë së kredisë së garantuar. Përqindja e tarifës së garancisë përcaktohet me Marrëveshjen e Garancisë. Tarifat e garancisë do të caktohen dhe shfrytëzohen për të mbuluar shpenzimet operative dhe humbjet eventuale kreditore të FKGK- së për të mundësuar qëndrueshmërinë e FKGK. Çfarëdo teprice e mbledhur e tarifave që tejkalon shpenzimet operative dhe humbjet eventuale kreditore do të mbahet në FKGK dhe përdoret për rritje të qëndrueshmërisë së FKGK- së.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 11

Neni 8, pas paragrafi 1, shtohet një paragrafi të ri (2) si vijon:

2. Lartësia e tarifës do të udhëhiqet nga parimet si vijon:

- a) Funksionimi, menaxhimi dhe administrimi udhëhiqet nga parimi i racionalitetit, efijencës dhe efektivitetit me shpenzimet administrative dhe kostot e tjera, duke siguruar qëndrueshmërinë e FKGK- së, dhe,
- b) FKGK do të ndërmarrë masat e duhura që niveli i tarifës të mos ndikojë në normat e interesit lidhur me financimin e huave të NMVM –së në nevojë.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 12

Neni 8, paragrafi 2, rreshti i pestë, pas shprehjes “këtyre vlerësimeve”, shtohet teksti si vijon “me qëllim të mbulimit të shpenzimeve operative dhe humbjeve kreditore”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 13

Neni 10, titulli riformulohet si vijon: "Themelimi dhe Forma e Organizimit e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore".

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 14

Neni 10, paragrafi 1 fshihet.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 15

Neni 10, paragrafi 5, riformulohet si vijon:

5. Çdo e hyrë që pranon FKGK nga tarifat, kthimi në investime, donacionet apo ndonjë e ardhur tjetër e pranuar ligjërisht dhe në bazë të këtij ligji dhe ligjit të aplikueshëm, duhet të rregullohet me dispozitat e këtij ligji dhe Statutit dhe Politikave e Procedurave të Brendshme të FKGK-së në fuqi. Në rast të mospërputhjeve me ligjet e tjera në fuqi në lidhje me buxhetin dhe shpenzimet e FKGK, ky ligj mbizotëron. Çfarëdo teprice e mbledhur e tarifave që tejkalon shpenzimet operative dhe humbjet kreditore do të mbahet në FKGK për qëllime të funksionimit tij dhe nuk do të shpërndalet jashtë FKGK në asnjë formë apo mënyrë duke përfshirë edhe dividendën.

Besim Beqaj tha se duhet të shmanget "ky mbizotërimi i këtij ligji" ose duhet të shtohet se "përveç ligjit për BQK".

Raif Qela tha se fjalia "ligjit të aplikueshëm" duhet të jetë "legjislacionit të aplikueshëm".

Kryetari po ashtu tha se pjesa e fundit ku fillon "...Çfarëdo teprice..." duhet të fshihet sepse përsëritet në disa vende.

Pas debatit Komisioni miratoi amendamentin 15 si vijon:

Amendamenti 15

Neni 10, paragrafi 5, riformulohet si vijon:

5. Çdo e hyrë që pranon FKGK nga tarifat, kthimi në investime, donacionet apo ndonjë e ardhur tjetër e pranuar ligjërisht dhe në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit të aplikueshëm, duhet të rregullohet me dispozitat e këtij ligji, Statutit dhe Politikave e Procedurave të Brendshme të FKGK – së në fuqi. Në rast të mos përputhjeve me ligjet e tjera në fuqi, në lidhje me buxhetin dhe shpenzimet e FKGK-së, ky ligj mbizotëron, përveç ligjit për BQK- në.

Amendamenti 16

Neni 12, paragrafi 1, në fund të tekstit shtohet teksti si vijon:

Çfarëdo teprice e mbledhur e tarifave që tejkalon shpenzimet operative dhe humbjet eventuale kreditore do të mbahet në FKGK për qëllime të funksionimit të tij dhe nuk do të shpërndahet jashtë FKGK- së në asnjë formë apo mënyrë duke përfshirë edhe dividendën.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 17

Neni 13, fshihet pika 1.6

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 18

Neni 16, paragrafi 17, riformulohet si vijon:

17. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, me përjashtim të Drejtorit Menaxhues të FKGK-së, marrin kompensim të arsyeshëm për pjesëmarrjen në mbledhjet e Bordit, që do të specifikohet me Statutin dhe Politikat e Procedurat e Brendshme dhe në bazë të buxhetit të FKGK- së.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 19

Neni 17, paragrafi 1.10, në fund të tekstit të paragrafit shtohet teksti si vijon “më qëllim të mbulimit të shpenzimeve operative dhe humbjeve kreditore të PKGK- së”.

Besim Beqaj propozoi që të fshihet ky amendament sepse është i panevojshëm.

Propozimi i z.Beqaj u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 20

Neni 19, paragrafit 10, i fshihet teksti “FKGK pajtohet që të rimbursojë punëtorin apo agjentin e FKGK-së, ndaj humbjeve, pretendimeve, përfshirë pretendimet e palëve të treta, dëmet dhe detyrimet, të cilat mund të parashihihen sipas Ligjit të aplikueshëm. ”

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 21

Neni 23, paragrafi 3, në vend të “30 prill” zëvendësohet me “30 qershor”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 22

Neni 23, paragrafi 6, riformulohet si vijon:

6. Drejtori Menaxhues është përgjegjës që Bordit të Drejtorëve t'i dorëzohen pasqyrat e audituara financiare të FKGGK- së, së paku 15 ditë para finalizimit dhe aprovimit të tyre.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 23

Neni 23, shtohet paragrafi i ri 7, me tekstin si vijon:

7. FKGGK duhet të publikojë raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara financiare në faqen e tij të internetit, e cila do të jetë e hapur për publikun.

Kryetari tha se fjalia e fundit “e cila do të jetë e hapur për publikun.” të fshihet sepse është e panevojshme, është diçka që dihet.

Propozimi i kryetarit u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 24

Neni 25, paragrafi 1.4, fshihet.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 25

Neni 26, i shtohet teksti “sa i përket organizimit të tij”

Besim Beqaj tha se në vend të këtij propozimi të vendoset sikurse të amendamenti i mëparshëm teksti “përveç ligjit për BQK.”.

Propozimi i z.Beqaj u përkrah nga Komisioni.

Pas miratimit të amendamenteve një për një, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Amendamente i Projektligjitnr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore;
2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme, sipas procedurës së rregullt.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-058 për Dizajnin Industrial

Kryetari, në cilësinë e kryesuesit të Grupit të punës, theksoi se Projektligji është miratuar në legjislaturën e kaluar dhe tani më kemi vetëm inkorporimin e Direktivave të BE-së dhe Grupi i punës ka bërë vetëm disa amendamente teknike, por i kemi dy dilema të neneve 11 dhe 48, pastaj i prezantoi amendamentet një nga një.

Amendamenti 1

Neni 3, nënparagrafi 1.1, riformulohet si vijon:

1.1. Ministria - Ministria kompetente për pronësinë industriale.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 3, nënparagrafi 1.2 riformulohet si vijon:

1.2. Ministër-Ministri i Ministrisë kompetente për pronësinë industriale;

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 11, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Dizajnues është personi fizik dhe juridik i cili ka krijuar dizajnin industrial.

Kryetari tha se për këtë amendament e kemi kundërshtimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe hapi debat.

Blerim Grainca tha se edhe në parim kur e kemi diskutuar e kam ngritur këtë çështje se pse nuk kanë të drejtë edhe personat juridik të krijojnë dizajn.

Veli Hoti (MTI) tha se këtu është fjala për “dizajnuesin”, e jo për të drejtën me pasur dizajnë sepse e kemi nenin 15, ku i jepet e drejta ta kenë dizajnin e vet edhe personat fizikë edhe juridikë dhe kjo çështje është e rregulluar edhe me Direktatvat e BE-së dhe ne e kemi harmonizuar këtë ligj.

Pas debatit Komisioni nuk e përkrahu amendamentin 3.

Amendamenti 4

Neni 19, paragrafi 3, fjala “licencë” zëvendësohet me “të drejtë”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 5

Neni 28, nënparagrafi 1.3 fjala “dydimenzional” zëvendësohet me “tredimenzional”

Veli Hoti (MTI) tha se nuk e përkrahim këtë amendament, sepse ne s'kemi si i publikojmë në Buletinin e API-t.

Komisioni nuk e përkrahu këtë amendament.

Amendamenti 6

Neni 34, paragrafi 2, pas fjalës “Agjenci” shtohet teksti: “brenda afatit prej 3 (tre) muajsh”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 7

Neni 34, paragrafi 3, referenca “paragrafit 2” zëvendësohet me “paragrafët 1 dhe 2”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 8

Neni 40, fshihet referenca “paragrafi 1”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 9

Neni 40, paragrafi 8, referenca “paragrafit 5” zëvendësohet me “paragrafi 7”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 10

Neni 48

Kryetari tha se këtu nuk kemi amendament sepse kemi kërkuar sqarim nga ministria lidhur me afatin e mbrojtjes së dizajnit, i cili është 5 vjet dhe mund të shtyhet deri në 25 vjet, ku hapi debat.

Veli Hoti (MTI) tha se siç është paraqitur këtu kjo çështje mbrohet më Konventa ndërkombëtare dhe ne e kemi adoptuar ashtu siç është edhe në nenin 48 dhe s'mund të ndryshohet.

Komisioni nuk e ndryshoj nenin 48.

Amendamenti 11

Neni 49, paragrafi 4, referenca “me nenet 1 dhe 2” zëvendësohet me “me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 12

Neni 50, paragrafi 4, pas fjalës “Komisionit” shtohet fjala “të ankesave”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 13

Neni 65, fjala “exploatim” zëvendësohet me fjalën “përdorim”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 14

Neni 66, paragrafi 1, fjalia “procedurë në gjykatë” zëvendësohet me “procedurë gjyqësore”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 15

Neni 71, paragrafi 1, referenca “nenin 15” zëvendësohet me “nenin 16”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 16

Neni 83, paragrafi 2, referenca “sipas paragrafit 1. i këtij neni “ zëvendësohet me “për shkeljet sipas nenit 17 të këtij ligji”.

U miratua nga Komisioni.

Pas miratimit të amendamenteve një për një, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me Amendamente i Projektligjit nr. 05/L-058 për Dizajnin Industrial*
- 2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme, sipas procedurës së rregullt.*

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës

Kryetari tha për këtë projektligj Grupi i punës e ka shqyrtuar projektligjin dhe ia dha fjalën deputetes, znj. Sala Berisha – Shala.

Sala Berisha – Shala, në cilësinë e kryesueses së Grupit të punës theksoi së Projektligji është miratuar në legjislaturën e kaluar dhe tani më kemi vetëm inkorporimin e Direktivave të BE-së dhe Grupi i punës ka bërë vetëm disa amendamente teknike të cilat i prezantoi një nga një.

Amendamenti 1

Neni 4, nënparagrafi 1.1, riformulohet si vijon:

- 2.1. Ministria - Ministria kompetente për emërtime të origjinës dhe treguesve gjeografikë.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 2

Neni 3, nënparagrafi 1.2, riformulohet si vijon:

- 2.2. Ministër-Ministri i ministrisë kompetente për emërtime të origjinës dhe treguesve gjeografikë.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 3

Neni 14, në paragrafet 3 dhe 4, teksti “emri i origjinës i mbrojtur” dhe “treguesi gjeografik i mbrojtur” si dhe “emri i origjinës i mbrojtur” dhe “treguesi gjeografik i mbrojtur” zëvendësohen me “emërtim i origjinës i mbrojtur” dhe “tregues gjeografik i mbrojtur”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 4

Neni 20, titullohet si vijon: “Treguesit gjeografikë ndërkufitarë”.

U miratua nga Komisioni.

Amendament 5

Neni 35, paragrafi 2, fjalia “në gazetën zyrtare” zëvendësohet me “në Buletinin zyrtar”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 6

Neni 39, paragrafi 1, referenca “1.5” zëvendësohet me “1.4”.

U miratua nga Komisioni.

Amendamenti 7

Neni 39, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

Në rastet kur procedura e anulimit është e bazuar sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 dhe nënparagrafin 1.4 të këtij neni, nenit 33 dhe nenit 34, paragrafi 5 të këtij ligji do të zbatohet sipas kushteve të caktuara.

Raif Qela tha se ky amendament duhet të riformulohet edhe një herë sepse edhe si në projektligj edhe këtu në amendament është i paqartë dhe propozoi si vijon:

2. Në rastet kur procedura e anulimit është e bazuar sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 dhe nënparagrafin 1.4 të këtij neni, nenit 33, si dhe nenit 34 paragrafi 5 të këtij ligji, atëherë procedura e anulimit do të zbatohet sipas kushteve të caktuara.

Propozimi i z. Qela u përkrah nga Komisioni.

Pas miratimit të amendamenteve një për një, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Amendamente i Projektligjit nr. 05/L-051 për 05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

3. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme, sipas procedurës së rregullt.

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike

Kryetari tha për këtë projektligj, po ashtu, kemi një Grup pune ku është raportues z. Fatmir Rexhepi. Për këtë projektligj, po ashtu, kemi angazhuar ekspertin, z. Bujar Pira. Pastaj ia dha fjalën zotit Rexhepi për të paraqitur raportin me amendamente.

Fatmir Rexhepi tha se eksperti na e ka dërguar një draft më propozim-amendamente si dhe stafi që i ka bërë disa vërejtje të tij, por Grupi i punës nuk ka mundur të mbledhet që ta shqyrtojë raportin me amendamente, dhe kërkoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike.

**7. Të ndryshme
Çështje vijuese**

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa